



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Nr \_\_\_\_\_ Prot.      Datë 08. 01. 2010

DREJTUAR ; Z. Andrea Stefani, IREX senior media advisor for the Democracy and Governance project in Albania.

PER DIJENI ; w. Robert Pearson, IREX DC President,  
Paige Alexander, IREX Europe President,  
Mike de Villiers, IREX Europe Director,

OBJEKTI ; Komente mbi Investigimin e Programit "Hapur", me titull; Korrupsioni ne Portin e Duresit.

I nderuari z. Andrea Stefani.

Kemi ndjekur me vemendje transmetimin e Investigimit, Programi "Hapur", Lidhur me "Korrupsionin ne Portin e Duresit", realizuar nga gazetarja Yllka Kamenica.

Gjithashtu, kemi shqyrtuar me kujdes cdo "fakt" te permendur ne kete investigim per te vertetuar nga zyra Juaj, sic e thoni qe ne fillim se,

*Porti i Duresit, me i madhi ne vend, eshte shnderruar ne nje nga qendrat kryesore te shperdorimit te detyres, te abuzimeve me fondet e dhena nga buxheti i shtetit dhe Grandet..*

Ju sigurojme se ne shqyrtimin tone, kemi treguar mjaft vullnet dhe kemi bere çdo perpjekje per ta pare Investigimin Tuaj pozitivisht, per ta mbrojtur arsyetimin tone nga çdo influence emocionale te natyres njerezore, por njekohesisht pse jo dhe si nje menyre te pari duke kerkuar e gjetur çdo mundesi dhe per te reflektuar.. (Ju lutem, nuk ka qene e lehte).

Gjithashtu, do te ishte e dobishme, qe me pare se te parashtrojme çeshtjet para Jush, te njehësonim menyren e te parit te gjerave, per te cilen biem dakort qe ne fillim se do te jete veçse ajo e shpallur qe ne krye te programit Tuaj, se;

#### KORRUPSIONI ESHTË AUTORITET PLUS MONOPOL MINUS TRANSPARENCE

Si dhe ne ;

#### "ÇËSHTJET KRYESORE DHE OBJEKTIVAT ;

Mbështetje mediave të pavarura që të angazhoje qytetarët, OJQ-të, mediat dhe palët në politike, për të përmirësuar transparencën, për të luftuar korrupsionin, dhe për të promovuar më të mirët në qeverisje.

### A. ANALIZA E FAKTEVE,

#### 1. KOMUNIKIMI ;

Do te donim ta permendim, si dhe kerkojme qe te njihet si nje fakt nga ana e Juaj se;

- 1.1 Gazetares se emisionit Znj. Kamenica, i eshte rezervuar nga institucioni yne nje pritje mjaft korrekte, si dhe i eshte vleresuar seriozisht kerkesa e Saj me shkrim per dhenie informacioni.
- 1.2 Ne pergjigje i jane dhene te gjitha dokumentat e nevojshme per ç'ka kerkohej, per kryerjen e misionit te Saj pa asnje veshtiresi.
- 1.3 Gjithashtu, i gjithë informacioni i lidhur edhe "bukur" (ndonëse i përmendur me cinizëm në emision), u shoqërua dhe me një relacion shpjegues enkas, të plotë e shumë të qarta, shkruar ky me një gjuhë të zgjedhur (në respekt të medias)..

Lutem, Z. Stefani vereni nese vertet keto qe shenuam jane te verteta dhe nese si kane cilesite qe ne u japim.

#### 2. QELLIMI I KRYERJES SE KETIJ INVESTIMI,

Ne Relacionin tone shpjegues Nr. \_86\_ , dt. 30. 09 . 2009, Blloku "I", shenohet qarte se:

*Duke ju pergjigjur pyetjeve te pergatituar nga IREX e nepermjet Tij dhe interesimit te publikut, mendoj se do ishte me interes dhe njekohesisht me e thjeshte per tu kuptuar, nese ne kete bllok informacioni, se pari te spiegohej qellimi i ketij investimi..*

#### 1. QELLIMI I INVESTIMIT,

Buron nga e veçanta e Terminalit tone te Pasagjereve, ne te cilin mund te akostohen dhe perpunohen, pese tragete njekohesisht, ku per shkak te gjeometrise se rrafshit te terminalit, kater prej tyre ankorohen ne menyre te veçante, qe konsiston ne lidhjen e tyre ne kalate vetem me dy litare ne kic (fund), ndersa bashi (maja) lidhet ne det !!, vetem me Spirancen e Anijes!!, Shih Skemen \_1, te akostimit dhe ancorimit te Anijeve ne terminal..

- 1.1 Pas ketij shpjegimi, mund te kuptohet se duke mos qene te lidhura me kalaten edhe ne bash (maje), qëndrueshmeria e lidhjes se tyre eshte nen ndikimin e forte te faktoreve atmosferik,
- 1.2 Sipas studimeve ; "KARAKTERISTIKAT KLIMATERIKE DHE HIDRODINAMIKE TE GJIRIT TE DURRESIT PERGATITUR NGA WRED 200b", si dhe , "STUDIM BATIMETRIK I PORTIT TE DURRESIT, SHENUAR NE RAPORTIN E STUDIMIT DETAR MAJ 2002 PERGATITUR NGA OCEAN SURVEYS, INC \_OSI 2002", shpejtesia e max.eres, ne kohe te keqe, arin deri ne 130-150 km/ore, dhe shpejtesia e rrymave te ujit ne akuarium mes. 0.250m/sek, pas kesaj kuptohet se lidhja e tyre eshte tejte e rrezikuar dhe e pa sigurte,
- 1.3 Vlen te kujtohen ngjarje te ndodhura me pare, ku pikerisht per shkaqe atmosferike kane ndodhur disa incidente, fatmiresisht vetem me deme materiale.

Ndaj, marja e masave per te sjelle sigurine ne akostim dhe ancorimin e anijeve, per te evituar ndonje katastrofe te mundeshme, ka qene dhe qellimi i ketij investimi.

Z. Stefani, lutemi verifikoni fillimisht nese vertet;

- a. Tragetet akostohen ne terminal sipas skemes\_1 te dhene programit Tuaj, si dhe;
- b. Ekzistojne kushtet atmosferike te shenuara ne bllokun "I", pika 1.2, te relacionit shpjegues nr. 86.

Verifikimi i pikes "a", nuk mendojme se perben ndonje problem per askënd, pasi edhe çdo gazetar mund ta vërej menyren e vendosjes dhe lidhjes se trageteve ne kalate te terminalit. (Lutem shikoni Lidhjen\_2 te doc. Bashkangjitur)

Per Verifikimin e te dhenave shenuar ne piken "b"., si dhe thote Znj. Kamenica, mundet ti drejtoheni Institutit Metrologjik, si dhe atij Hidrometrologjik prane Universitetit te Tiranës,

Ne personalisht, siç e kemi shenuar ne dokumenta, kemi preferuar ti nxjerrim ato nga studimet e shumta te kryera nga studio e kompani te huaja prestigjioze, me porosi te shtetit shqiptar, qe gjenden ne arkivin tone teknik dhe qe jane prone e Autoritetit Portual Durres,(lutemi shikoni referencat per to Lidhja\_3, bashkengjitur) ç'ka mendojme se nuk mund te perbeje asnje problem per publikun menyra e vjeljes se informacionit, mjafton qe ai te jete i sakte dhe i çertifikuar, si dhe aktualisht rezulton .

Pas verifikimeve te mesiperme natyrshem do te shtronim pyetjen se;

Ne kushtet e akostimit te trageteve, shenuara ne "a", si dhe ne kushtet atmosferike te shenuara ne "b", me siper, ekziston vertet nje rrezik per katastrofe ?!

Lidhur me pergjigjen e kesaj pyetje, ne do te donim t'ju sygjeronim, qe programi Juaj te konsultohet me te vetmin institucion zyrtar te specializuar, ate te "Kapitenerise", i cili eshte kompetent dhe i ngarkuar me ligj per kontrollin dhe sigurine e trafikut detar, i cili varet nga Min. Transporteve ( jo nga ne ), por dhe te tjera institucione njohese te sigurse ne porte qe Ju do i gjykoni te arsyeshme..

Nese pas verifikimeve do te rezultonte vertet ne kushtet e permendura kjo do te perbente nje rrezik mjaft te madh per sigurine ne port , atehere ne mendojme se nga programi Juaj duhet te thuhet qarte dhe me ze te larte (**për të promovuar më të mirët ne qeverisje.**) se Qellimi i ketij investimi nga Autoriteti Portual eshte i drejte, se me kete Ai ka cfaqur nje pergjegjesi te larte ne kryerjen e detyres, se ka qene tejet i ndjeshem per fatet e publikut, duke bere saktesisht ate qe ka per detyre, per te parandaluar katastrofat e mundeshme ne port me pasoja te renda njerëzore...(do e beni vertet ?)

### 3. REALIZIMI,

Ne emisionin e Pergatitur nga Znj. Kamenica, eshte hedhur nje dyshim mjaft i madh lidhur me perzgjedhje e llojeve te fenderave si dhe perllogaritjet lidhur me to, duke mos pasur aspak si qellim te replikojme me gazetaren, do te donim fillimisht te saktesojme disa gjera.

Se pari, Thenia ne emision, se keto lloje fenderash "**jane te projektuara dhe prodhuara per tu vendosur ne pjeset anesore te anijeve qe perpunojne mallra ndermjet tyre ne det te hapur**", nuk eshte absolutisht e vertete, lutem shikoni per kete rekomandimet perllogaritese te kompanive te njohura BARMORAL, FENDER CARE, AUSTRALIAN FENDERS, NOREQ, ANCHOR, etj, (**Lidhja 6 dhe Lidhja 7**), ne te cilat shenohet se;

Perllogaritja e fenderit do te behet sipas kushteve te vendosjes, Ship-to Ship example, ose Ship-to-Quay example, cka do te thote se llojet e fenderave gjejne perdorim si ndermjet anijeve me anije po ashtu dhe ndermjet anijeve kalate.

Se dyti, eshte e nevojshme te saktesojme se ne kete rast, perdorimi i fenderave si e kemi shprehur ne rubriken "qellimin e investimit", por dhe si eshte i realizuar ne fakt, shtrihet vetem ne hapsiren e acostimit te traqeteve ne terminal ku perpunimi i traqeteve nuk behet me elektrovinca !!!, pasi kamionet dhe veturat dalin me rrotat e tyre, trajlerat terhiqen me traktor dhe pasagjeret dalin me kembe.. (duhet te mbahet mend kjo per mos tu ngaterruar !!) dhe;

nuk ka asnje lidhje me piese te tjera te kalatave te portit si dhe thuhet me qellim per tu ngaterruar ne investigimin e Zj. Kamenica, pasi ky projekt nuk shtrihet ne ato zona ku mund te jepte vertet ato efekte qe permenden prej Saj se, "**keto lloje fenderash jane ne kundershitime me strukturen detare te Standartit Britanik pasi rrisin distancen duke ulur aftesine e punes se elektrovincave**"

Ishte e nevojshme te jepej ky sqarim, pasi ne menyre automatike bien argumentat e Zj. Kamenica dhe ne kete pike..

Se Treti, eshte e nevojshme gjithashtu, te saktesojmë se fenderat pneumatik jane notues, lutemi shikoni spjegimet e kompanise FENDER CARE Marine Solutions te derguara ( **Lidhja\_7** ), por dhe te tjera , te cilat e emertojne saktesisht **Floating Fenders Pneumatic**, cka tregon qe ne emertim se, "jane te projektuara dhe prodhuara per te gene notues si dhe per te absorbuar energji per shkak se jane pneumatik, ne kete menyre bie dhe argumenti se ne termilogjine detare nuk ka emertim Fender Notues.

Lutem, Z. Stefani pasi te lexoni me vemendje c'ka saktesuam ne kete pjese te shkrimit, si dhe krahasuar me referencat e derguara, edhe pse nuk jeni nje specialist i fushes, ne mendojme se lehtesisht do te dalloni se saktesimet tona jane te drejta,

Pas kesaj, ju sygjerojme te rindegjoni materialin e pergatitur nga gazetarja Kamenica ne investigimin e saj ku menjehere do te vereni se;

Ky investim nuk mund te shpallej nga Znj. Kamenica se paku i gabuar, (po e themi perkohesisht me kete term), nese ketyre fenderave, se pari ti higej cilesia notuese, (qe nuk mund tja heqe dot) dhe se dyti te klasifikoheshin te pa pershtateshem per tu vendosur ne kalate, e thene kjo referuar standartit britanik qe si e shpjeguam me siper qellimisht Ajo e ngaterron!!

#### 4. PROJEKTIMI DHE PERLLOGARITJET,

Ne dokumentat e kesaj procedure prokurimi, gjenden te lidhura korespondencat me kompani te huaja te cilat, pasi u kemi derguar planimetrine e terminalit te traqeteve, menyren e akostimit te traqeteve ne kalate, te dhenat metereologjike e hidrometereologjike, si dhe qellimin, na kane dhene ne menyre te pavarur prej njera tjetres te njejten tipologji zgjidhje, ate te cilen e kemi zbatuar, per shkak te permasave, ju ftojme ti shihni ne Port, ne çdo kohe qe deshironi.

Perllogaritjet, jane kryer nga personeli inxhinjereve te komisionit, eshte plotesisht ne formimin e tyre profesional te kryejne perllogaritje te tilla, inxhinjer do te thote zgjidhje, cdo gje qe ka nje perdorim sot eshte vecse nje aplikim inxhinjeric (ndonese sipas Znj.Kamenica nuk jane kompetente),

Shtojme ketu se perllogaritjet e tyre nuk bien aspak ndesh me liqjin, pasi nese sigurohen te dhenat hidrometereologjike dhe nese dihen permasat dhe menyra akostimit te traqeteve, perllogaritjet mund ti krye cdo inxhinjer (aq me mire Mekanik), metoda perllogaritese e tyre rekomandohet nga çdo prodhues dhe shites ..(**shih Lidhjen 6**)

#### 5. EDHE NJEHERE MBI KOMUNIKIMIN,

Edhe se kete çeshtje e trajtuam ne fillim ne piken 1, kreu A, do te donim qe ne kete rubrike te shtronim disa çeshtje te tjera, te cilat per shkak te struktures se shkrimit por dhe per shkaqe etike, nuk mund t'i shprehnim qe ne fillim.

1. Fillimisht dhe ketu, do te donim te benim nje sqarim paraprak, per t'ju thene se te gjitha dokumentat e veprimtarise se Autoritetit Portual, ruhen si fizikisht ne Arkivin e saj, po ashtu dhe ne menyre elektronike. Kerkeses per informacion te paraqitur nga programi Juaj, i jemi pergjigjur nepermjet arkivit elektronik, ndaj dhe ne to nuk ka firma dhe vula,

Bashkengjitur ketij shkrimi ju dergojme dokumentet me firme per te demonstruar se ato te dorezuara Ju me pare, jane te verteta, per shembull;

Dyshimi aq i madh se Autoriteti Portual fsheh te verteten (pse.?? !!), lidhur me perberjen e anetareve te komisionit hartues te dokumentave, shihet menjehere qarte se jane ata te deklaruar ne dokumentat e dorezuara Ju me pare, pra jane te njejtet ne te dyja rastet!!, (eshte praktike e jona te jene po ato, pasi hartuesit e specifikimeve jane njekohesisht dhe kolauduesit me te mire).

Me kete rast do te donim te deklarojme te njejten gje dhe per cdo dokument tjeter te dhene, si per perlogaritjet, specifikimet teknike etj,( lutem shihni **Lidhjet 1,4,5** te doc. Bashkengjitur )..

- Z. Stefani pas kesaj, verehet se Autoriteti Portual jo vetem ka gene korrekt me kerkesen e programit Tuaj, si shenohet ne fillim, por rezulton se kemi gene dhe tejet Serioz, ne kundershtim kjo me theniet mjaft te renda te Zj. Kamenica ne emisionin e Saj investigativ

## B. PERFUNDIMI YNE

I Nderuari Z. Stefani, Sapo demonstruam me fakte dhe prova (do te luteshim te siguroheni dhe Ju), te cilat vertetojne se emisioni investigativ i pergatitur nga gazetarja e programit Tuaj Znj. Kamenica, mbeshtetet ne te dhena te fakteve te deformuara (qellimisht), por dhe ne nje optike te shqyrtimi dashakeqe.

### 1. INVESTIGIMI ;

- 1.1 Nese vertet eshte nje emision investigativ, lutem çfarë ka investiguar konkretisht Znj. Kamenica ?. A mund te jete i tille (investigativ) nese nuk ka kontaktuar se paku nje here me te gjithë palet ne kete ceshtje ??!!,

- 1.2 Nese "Mburret" se ka kontaktuar me Specialistin Tomorr Spahiu, i cili ka qene i vetmi qe e ka "kundershtuar" kete projekt, ç'e ka penguar ate te merte kontakt dhe me autoritetet ne Port, etj., e te kerkonte çdo sqarim qe deshironte..
- 1.3 A e ka kundershtuar vertet Z. Spahiu kete projekt !!, Nese nisemi nga koha e nderprerjes se mardhenieve te punes me Te (04.06.2008), dhe prokurimit te ketij projekti (tetor 2007), nuk duket ndonje lidhje e drejperdrejte, Gazetarja duhej ta investigonte kete rast, pasi nderprerja e mardhenieve te punes ka ardhur per moszbatim te detyrave te tjera te cilat nuk kane lidhje me ceshtjen dhe kjo i duhej thene qarte publikut.. ( i duhej nje "Disident" ne emision ??),
- 1.4 Cilet jane personat e larguar nga puna te cilet kane pasur " frike" te prononcohen, (te larguar dhe kane frike akoma !!??, e beson njeri !!)
- 1.5 Çfare duhet te kuptojme me termin e perdorur "Administrata e Re", ajo e emeruar nga Partia Demokratike ?!, publiku duhet te informohet patjeter se cila parti e ka emeruar administraten e Autoritetit Portual apo vetem si punon ajo... (kemi parasysh ketu programin Tuaj qe nuk duhet ta lejoje..) , nese Znj. Kamenica nuk ben dot ndryshe, i veme ne dispozicion filmime te Portit ne kohen e " Administrates se Vjeter.. "
- 1.6 Çfare investigimi ka bere Znj. Kamenica lidhur me ate qe Ajo thote se Porti i Duresit me i madhi ne vend eshte kthyer ne nje nga qendrat me te medha te shperdorimit te detyres dhe abuzimeve me fondet....?
- 1.7 Çfar investigimi ka bere Znj. Kamenica lidhur me ate qe Ajo thote se "drejtori i portit dhe stafi kane perfituar shuma te medha parash nga tenderat e organizuar ne kundershtim me ligjin....?
- 1.8 Nese vertet eshte nje emision investigativ, mendojme se natyrshem Znj. Kamenica do kish mare kontakte dhe me institucione te tjera per te vertetuar ato qe ajo thote..
- 1.9 Gjithashtu duhet te kishte marre kontakt dhe me autoritetet e Portit, ne menyre qe te gjitha shpjegimet ne kete shkrim t'i kishte marre qe me pare,

1.10 Vetem pas ketyre veprimeve emisioni i Saj, do te kishte cilesine si i drejte dhe i ndershem perpara publikut (por dhe para ndergjegjes se Vet !! ).

C. NE MBYLLJE

I nderuari z. Stefani, Ne kete shkrim, sapo demonstruam me fakte dhe prova per te cilat do te luteshim te siguroheni dhe Ju, te cilat vertetojne se emisioni investigativ i pergatitur nga gazetarja e programit Tuaj Znj. Kamenica, mbeshtetet ne te dhena e fakte te pa investiguara, te deformuara qellimisht, duke demonstruar njeanshmeri paaftesine, si dhe mungesen e theksuar te etikes se profesionit, duke demtuar jo vetem imazhin e Autoritetit Portual dhe Stafit Drejtues, por dhe ate te programit tuaj.

Ne cilesine e drejtuesit te Programit "Hapur" per Shqiperine, lutemi merrni ato masa te cilat do i konsideroni te pershtatshme me qellim qe ;

se pari, te rindertohet imazhi Yne i demtuar nga ky emision.

se dyti, kjo te mos perseritet me,

se treti, te analizohet ne veçanti veprimtaria e Gazetares Kamenica pasi si e thoni Ju ne Program (**KORRUPSIONI ESHTË AUTORITET PLUS MONOPOL MINUS TRANSPARENCE**), duket se ne kete rast, eshte treguar nje autoritet absolut, duke shperfillur fakte, duke ndertuar vete te tjera, si dhe duke trasmetuar ç'te doje, ne kete menyre eshte demonstruar jo vetem nje autoritet absolut, por dhe mungese transparence ndaj publikut, mbetet vetem qe kjo te jete dhe monopoli i Saj,

Lutemi Z. Stefani, mos lejoni monopolin, thuajini publikut te verteten per çka ka ndodhur..

Me Konsideraten e te larte per Ju, Pershendetje miqesore

Drejtori i Drejtorise Inxhinjerike  
Ing. Mehmet Borshi